




|| N=ESG 

BIZNESE TË QËNDRUESHME

Ky projekt financohet nga Agjensia e Start UP





Të nderuar lexues,
Në thelb të misionit tonë të Q-Lever qëndron angazhimi për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të forcuar lidhjet e bizneset me të rinjtë që ndajnë të njëjtat vlera.

Në frymën e transparencës dhe ndarjes së njohurive, kemi kënaqësinë të prezantojmë rezultatet e anketës sonë më të fundit mbi implementimin e praktikave ESG (Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes) në Shqipëri. Ky studim gjithëpërfshirës përfshin përgjigjet e mbi 121 kompanive nga 10 industri të ndryshme, duke ofruar një pasqyrë të rëndësishme mbi perceptimet dhe sfidat me të cilat përballen bizneset shqiptare në këtë fushë. Rezultatet tregojnë një ndërgjegjësim të shtuar për rëndësinë e ESG, veçanërisht midis bizneseve që veprojnë në tregje ndërkombëtare. Megjithatë, sfida të tilla si mungesa e burimeve financiare dhe teknike vazhdojnë të pengojnë implementimin e tyre.


Nga ana tjetër, është inkurajues fakti se kompanitë që kanë integruar ESG në strategjitë e tyre po përfitojnë nga rritja e reputacionit, tërheqja e investimeve dhe krijimi i një kulture më të qëndrueshme dhe inovative.

Ky raport synon të nxisë një diskutim të thelluar mbi potencialin e ESG për transformimin e biznesit dhe përmirësimin e ekosistemit në Shqipëri.

Ne besojmë se përmes angazhimit të përbashkët, mund të krijojmë një të ardhme më të qëndrueshme dhe më konkurruese për të gjithë.

Faleminderit për mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj në këtë rrugëtim të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

HYRJE



Q-Lever shpk është një start up vendas dhe është anëtare e Global Reporting Initiative, një rrjet ndërkombëtar me fokus raportimin për zhvillimin e qëndrueshëm.

Misioni i Q-Lever është të ndihmojë klientët e saj që të realizojnë përmirësime të qënësishme në performancën e tyre financiare, të zhvillojmë praktika që mundësojnë zhvillimin dhe trajnimin e të rinjve dhe të krijojmë rrjetëzim harmonik të aktorëve të biznesit, akademisë dhe të rinjve.

Q - Lever shpk është kompania që implementon projektin IN-ESG një projekt i financuar nga Agjensia e Start UP.

SHËRBIMET



Q-LEVER

IN ACADEMY

Paketa jonë e trajnimeve dhe kurseve të formimit profesional është ideuar që të ndikojë në zhvillimin profesional të individëve që kanë të rëndësishme zhvillimin dhe rritjen në karrierë.

IN SURVEY

Ne ofrojmë kryerjen e anketave dhe studimeve të tregut në fusha të ndryshme dhe synojmë që të informojmë klientët tanë mbi pritshmëritë dhe zhvillimet që kanë sektorë të ndryshëm në ekosistemin tonë.

IN CONNECT

Shërbimet tona të ndërlidhjes synojnë të lehtësojnë ndërlidhjen ndërmjet klientëve tanë, grupit të ekspertëve dhe të rinjve që janë pjesë e ekosistemit tonë.

IN RISK

Shërbimet e menaxhimit të rrezikut përfshijnë një qasje gjithëpërfshirëse për identifikimin, vlerësimin, zbutjen dhe monitorimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në objektivat e biznesit.

In ESG



IN ESG, synojmë të rrisim ndërgjegjësimin për zhvillimin e qëndrueshëm tek aktorët kryesorë të ekosistemit dhe të promovojmë përfitimet e harmonizimit të praktikave të qëndrueshme me menaxhimin efektiv financiar.

Raport mbi Gjetjet e Sondazhit



Biznese të Përgjegjshme

Ky raport analizon gjetjet kryesore nga anketa mbi implementimin e praktikave mjedisore, sociale dhe të mirëqeverisjes korporative (ESG) në sektorë të ndryshëm të industrisë. Të dhënat u mblodhën nga pyetjet e ndara në 7 kategori kryesore që synojnë të masin perceptimet dhe praktikatat e bizneseve shqiptare lidhur me ESG. Anketa përfshiu kompani nga sektorë të tillë si energjia, tregtia, ndërtimi, konsulenca dhe turizmi.



KAMPIONËT e ANKETËS



Biznese të Përgjegjshme

Periudha

Gusht 2024 – Dhjetor 2024


Përgjigje në total

121

Industri


10

Kampioni sipas madhësisë së kompanisë



- Kompani të mëdha
- Kompani të mesme
- Kompani të vogla

KAMPIONI SIPAS INDUSTRIE



- Edukim
- Energji
- Institucione publike
- Konstruksion
- Ndërtim
- Shëndetësi
- Sherbime Financiare
- Shërbime
- Tregti



Ndërgjegjësimi dhe përfitimet e ESG për bizneset

Anketa tregoi se ndërgjegjësimi për ESG është në rritje në Shqipëri, me 70% të bizneseve që deklaruan se kanë filluar të integrojnë ESG në strategjitë e tyre.

Ky trend është veçanërisht i dukshëm në sektorë si konsulenca, ku 90% e kompanive raportuan njohuri të thella mbi ESG, duke e bërë atë një pjesë të rëndësishme të operacioneve të tyre.

Shumica e bizneseve pranojnë se ESG ndikon pozitivisht në suksesin e tyre afatgjatë, me 85% të kompanive në sektorin e energjisë që e lidhin atë me rritjen e vlerës së tyre tregtare. Përfitimet përfshijnë rritjen e reputacionit, tërheqjen e partnerëve strategjikë dhe një fokus më të madh në efikasitetin operativ, duke e bërë ESG një komponent strategjik për rritjen afatgjatë.



Sfidat financiare dhe teknike për zbatimin e ESG

Pavarësisht përfitimeve të qarta, shumica e bizneseve raportuan mungesë të mbështetjes financiare për implementimin e ESG.

Vetëm 30% e kompanive në sektorin e konsulencës kanë buxhet të dedikuar për këtë qëllim, ndërsa sektorë të tjerë, si ndërtimi dhe tregtia, përballen me vështirësi financiare dhe teknike.

Këto sfida janë theksuar më tej nga mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, duke e bërë të vështirë për shumë biznese të përqafojnë praktikatat e qëndrueshmërisë.

Për të adresuar këtë, është thelbësore krijimi i skemave të mbështetjes financiare nga qeveria dhe forcimi i partneriteteve publike-private, duke përfshirë edhe asistencën teknike dhe trajnimin e stafit për ESG.



ESG si katalizator për tërheqjen e talenteve dhe investimeve

Rezultatet e anketës tregojnë se ESG ndikon ndjeshëm në tërheqjen e investimeve dhe talenteve. 90% e pjesëmarrësve besojnë se praktikatat ESG ndihmojnë në tërheqjen e investimeve të huaja, veçanërisht në sektorin e energjisë, ku kompanitë kanë përfituar nga politikat e tyre mjedisore. Në të njëjtën kohë, 80% e të anketuarve theksuan se investimet sociale ndihmojnë në tërheqjen e talenteve të rinj, duke kontribuar në krijimin e një fuqie punëtore më të angazhuar dhe inovative.

Për bizneset, integrimi i ESG jo vetëm që ndihmon në plotësimin e pritshmërive të investitorëve dhe profesionistëve të rinj, por edhe krijon një avantazh konkurrues të dukshëm në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

Le të mbrojmë planetin tonë së bashku!



||N=ESG

ANALIZA E DETAJUAR



A jeni familjar me implementimin e praktikave mjedisore, sociale dhe të mirëqeverisjes korporative?




Rezultatet e anketës tregojnë një lidhje të qartë midis procesit të auditimit dhe ndërgjegjësimit për praktikat ESG. Kompanitë e audituara kanë një ndërgjegjësim më të lartë për ESG krahasuar me ato që nuk auditohen. Ky rezultat mund të shpjegohet nga faktorët e mëposhtëm:

1.Ndikimi i auditimit në proceset e qeverisjes: Auditimi rrit transparencën dhe kërkon përputhshmëri me standarde të larta, duke i detyruar kompanitë të jenë më të vetëdijshme për ESG.

2.Përfshirja e ekspertizës profesionale: Kompanitë e audituara shpesh bashkëpunojnë me profesionistë të fushës, të cilët mund të ofrojnë udhëzime dhe trajnime mbi ESG.

3.Ndikimi i tregjeve ndërkombëtare: Kompanitë e audituara shpesh operojnë në tregje ndërkombëtare ose ndjekin praktika që kërkohen nga partnerë dhe investitorë të huaj.

Lidhja midis Auditimit dhe Ndërgjegjësimit për ESG






A vlerësoni që implementimi në afat të gjatë i ESG ndikon në rritjen e vlerës tregtare të organizatës suaj?

Rezultatet e anketës tregojnë se **85.1%** e kompanive besojnë se implementimi afatgjatë i praktikave mjedisore, sociale dhe të mirëqeverisjes (ESG) ka një ndikim pozitiv në rritjen e vlerës tregtare të organizatës së tyre. Vetëm **14.9%** e kompanive nuk e shohin ESG si një faktor që ndikon drejtpërdrejt në këtë aspekt. Mbështetja më e lartë për ESG vjen nga kompanitë e vogla, ku **95.1%** e tyre raportojnë ndikim pozitiv, pasuar nga kompanitë e mesme me **85.9%**. Kompanitë e mëdha, megjithëse me një mbështetje të konsiderueshme prej **62.5%**, tregojnë një qasje më të kujdesshme ndaj përfitimeve të ESG, e cila mund të lidhet me kompleksitetin më të lartë të strukturave të tyre. Rezultatet konfirmojnë se ESG jo vetëm që përfaqëson një angazhim etik, por gjithashtu perceptohet si një strategji që kontribuon në përmirësimin e performancës financiare dhe reputacionit të kompanive, duke krijuar një avantazh konkurrues në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

Këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e ESG si një instrument kyç për suksesin afatgjatë të ekosistemit.



Ndikimi i ESG në Rritjen e Vlerës se kompanive





A ka filluar kompania juaj implementimin e ESG në strategjinë tuaj?




Rezultatet e anketës nga 121 kompani tregojnë një prirje pozitive drejt fillimit të implementimit të ESG, por me sfida të dukshme në lidhje me financimin e këtyre përpjekjeve. Në total, **69% e kompanive** raportuan se kanë nisur implementimin e ESG, ndërsa vetëm **26%** kanë buxhete të dedikuara për të mbështetur këto iniciativa. Sektorët si **Ndërtimi** dhe **Shëndetësia** tregojnë rezultate të plota për implementim, ku të gjitha kompanitë kanë nisur të integrojnë ESG. Sidoqoftë, sektorë si **Edukimi** dhe **organizatat jo fitimprurëse** hasin sfida të mëdha, me shumicën e tyre që mungojnë buxhete specifike. Për shembull, në sektorin e Edukimit, vetëm **30% e kompanive** raportojnë disponueshmëri financiare për ESG, pavarësisht se **80%** kanë nisur implementimin.

Sektorin e **Konsulencës**, megjithëse përfaqëson një pjesë të madhe të kampionit (57 kompani), paraqet një mospërputhje të konsiderueshme, ku vetëm **48%** kanë nisur ESG dhe një pjesë më e vogël ka burime financiare për ta mbështetur. **Tregtia** dhe **Shërbimet Financiare** tregojnë rezultate më të balancuara, me rreth **44%-60%** të kompanive që raportojnë buxhete dhe zbatim aktiv.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se ndërsa ndërgjegjësimi dhe përpjekjet për ESG po rriten, mungesa e financimit mbetet një pengesë e madhe për suksesin e këtyre praktikave në shumicën e industrive. Kjo thekson nevojën për mbështetje më të mirë strukturore dhe alokimin e burimeve për të siguruar përfitime afatgjata nga ESG.

Përqindja e Kompanive me Buxhet për ESG sipas Sektorëve






A besoni se investimi në impaktin social tërheq talentet e reja?



91.7% e kompanive besojnë se investimi në impaktin social ndikon në perceptimin e tyre si punëdhënës të preferuar, duke nënvizuar rëndësinë e kësaj strategjie për të tërhequr talentet e reja.

Rezultatet e anketës me 121 kompani tregojnë një mbështetje të fortë për idenë se investimi në impaktin social ndikon në perceptimin e kompanisë si një punëdhënës i preferuar nga të rinjtë. Në total, **91.7% (111 kompani)** e pranojnë këtë ndikim, ndërsa vetëm **8.3% (10 kompani)** nuk e konsiderojnë atë si një faktor kyç. Kompanitë e mesme tregojnë mbështetjen më të madhe, ku **95.3% (61 nga 64 kompani)** pajtohen me këtë qasje. Kompanitë e vogla ndjekin me një përqindje të lartë, **90.2% (37 nga 41 kompani)**, duke theksuar fleksibilitetin e tyre në adoptimin e praktikave me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet. Kompanitë e mëdha gjithashtu shfaqin një prirje pozitive, me **81.3% (13 nga 16 kompani)** që e vlerësojnë investimin social si një avantazh për tërheqjen e talenteve të reja. Në përgjithësi, këto të dhëna tregojnë qartë se investimi në impaktin social nuk është vetëm një angazhim etik, por edhe një strategji praktike që ndikon në forcimin e pozicionit të kompanive në tregun e punës. Me përqindje të larta të mbështetjes në të gjitha grupet, investimet sociale janë një element thelbësor për kompanitë që duan të tërheqin dhe mbajnë talentet e reja në një mjedis konkurrues.

Perceptimi mbi Investimet Sociale dhe sa tërheqës je si punëdhënës





A mendoni që praktikat mjedisore rrisin mundësitë për investime?



91.7% e kompanive besojnë se implementimi i praktikave mjedisore rrit mundësinë për të përthithur investime, me mbështetje të fortë në sektorët e Tregtisë, Shoqatave dhe Konsulencës.


Rezultatet e anketës me 121 kompani tregojnë një nivel të lartë besimi në ndikimin pozitiv të praktikave që përmirësojnë mjedisin mbi aftësinë e kompanive për të tërhequr investime më të larta. Në total, **91.7% (111 kompani)** kanë deklaruar se implementimi i këtyre praktikave mund të rrisë mundësitë e tyre për të përthithur investime, ndërsa vetëm **8.3% (10 kompani)** kanë shprehur skept ic i zëm.

Industria e **Konsulencës** përfaqëson grupin më të madh, ku **86% (49 nga 57 kompani)** besojnë në këtë ndikim. Po ashtu, sektorë si **Tregtia** dhe **OJF-të** tregojnë mbështetje të plotë, ku përkatësisht **93.8% (15 nga 16 kompani)** dhe **100% (6 nga 6 kompani)** e shohin këtë strategji si një avantazh për të tërhequr i nve sti m e.

Edukimi dhe **Ndërtimi**, tregojnë nivele të larta mbështetjeje me përkatësisht **80% (8 nga 10 kompani)** dhe **75% (6 nga 8 kompani)** që e vlerësojnë këtë ndikim pozitiv. Ndërkohë, sektori i **Shëndetësisë** dhe **Turizmit** janë unanimitë në përgjigjet e tyre, me të gjitha kompanitë që raportojnë besim të plotë në këtë ndikim.

Nga ana tjetër, më shumë skept icizëm vërehet në sektorët e **Shërbimeve Financiare**, ku **30% (3 nga 10 kompani)** kanë deklaruar se nuk e shohin këtë ndikim si domethënës, si dhe në **Konsulencë**, me **14% (8 nga 57 kompani)** që kanë shfaqur qëndrim të ngjashëm.

Ndikimi i Praktikave Mjedisore sipas Industrive





A ndikon qeverisja e mirë në rritjen e fitimeve kapitale dhe operacionale?

Rezultatet tregojnë një ndryshim të qartë në mentalitetin e kompanive: mirëqeverisja korporative perceptohet si një faktor kyç për rritjen e fitimeve kapitale dhe operacionale, me 89.3% të kompanive që besojnë në ndikimin e saj pozitiv.

Rezultatet e anketës tregojnë një ndryshim të rëndësishëm në mentalitetin e biznesit, ku mirëqeverisja korporative perceptohet gjithnjë e më shumë si një strategji e domosdoshme për rritjen e fitimeve kapitale dhe operacionale. Nga 121 kompani të anketuara, **89.3% (108 kompani)** janë të bindura për këtë ndikim pozitiv, ndërsa vetëm **10.7% (13 kompani)** shfaqin skepticizëm.


Në analizën sipas madhësisë së kompanive:

- **Kompani të mëdha: 68.8% (11 nga 16)** besojnë në ndikimin e mirëqeverisjes mbi fitimet, ndërsa **31.2% (5 kompani)** mbeten skeptike.
- **Kompani të mesme: 92.2% (59 nga 64)** e konsiderojnë mirëqeverisjen si një faktor rritjeje, me vetëm **7.8% (5 kompani)** që nuk pajtohen.
- **Kompani të vogla: 92.7% (38 nga 41)** mbështesin këtë perceptim, duke shfaqur një qasje të fortë pro-mirëqeverisjes.

Këto rezultate nënvizojnë një ndryshim të qartë të mendësisë në të gjitha grupet e kompanive, ku mirëqeverisja nuk shihet më vetëm si një praktikë e mirë menaxhimi, por si një mjet real për rritjen e qëndrueshme dhe përmirësimin e performancës financiare. Ndërkohë, skepticizmi mbetet më i dukshëm tek kompanitë më të mëdha, të cilat mund të kenë procese dhe procedura të vendosura tashmë dhe nuk shohin mundësi për ndryshime.



Ndryshimi i Mentalitetit: Mirëqeverisja dhe Rritja e Fitimeve



REKOMANDIMET

Implementimi i Standardeve të Qëndrueshmërisë në Të Gjithë Sektorët:

Ne besojmë në ndikimin pozitiv të mirëqeverisjes në rritjen e fitimeve dhe rekomandojmë që institucionet publike dhe organizatat e biznesit duhet të bashkëpunojnë për të hartuar udhëzime praktike dhe standarde të unifikuara bazuar në ligjet e aplikueshme.

Zhvillimi i Skemave Mbështetëse për Praktikën e Qëndrueshme:

Praktikat e qëndrueshme ndikojnë në tërheqjen e investimeve andaj është thelbësore krijimi i skemave të mbështetjes financiare, si grante, kredi me interes të ulët, dhe stimuj fiskalë, për bizneset që implementojnë këto praktika. Këto iniciativa do të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës dhe tërheqjen e kapitalit të huaj.

Fuqizimi i Aksesit në Edukim dhe Teknologji për Bizneset e Vogla dhe të Mesme:

Kompanitë e vogla dhe të mesme, të cilat përfaqësojnë një aktor të rëndësishëm të ekosistemit, kanë nevojë për qasje më të lehtë në edukim dhe teknologji për të zbatuar praktikën mjedisore, sociale dhe mirëqeverisjes. Krijimi i programeve të trajnimit dhe platformave dixhitale të dedikuara për këto biznese do të përshpejtojë përvetësimin e praktikave të reja.

Krijimi i Forumeve të Përbashkëta për Ndërgjegjësim dhe Bashkëpunim:

Për të përforcuar rezultatet pozitive, rekomandohet krijimi i forumeve publike-private ku bizneset dhe qeveria mund të ndajnë përvojat dhe të identifikojnë sfidat për zbatimin e praktikave të qëndrueshmërisë dhe mirëqeverisjes. Këto forume mund të shërbejnë gjithashtu si pika kyçe për krijimin e politikave të përbashkëta që mbështesin ekosistemin e biznesit.





Qeverisja



Socialle




Mjedisore

PËRFUNDIME

Ky sondazh tregon se bizneset shqiptare janë në proces të adoptimit të ESG, megjithë pengesat e financimit dhe mungesa e njohurive dhe kapaciteteve mbeten sfida kryesore.

Vazhdimi i këtyre praktikave mund të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e ekonomisë së qëndrueshme.

Sektori privat dhe publik duhet të bashkëpunojnë për të krijuar një mjedis që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirëson aftësinë konkurruese të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare.





| **Kontakt:**

Tel: +355 69 37 69292

Mail: info@qlever.al

web: www.qlever.al

Adresa: Rruga Naim Frashëri,
Nr. 62, Tiranë



**Mjedisore.
Sociale.
Qeverisje.**

|| N=ESG 